

KËRKESE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR NDALIMIN E PËRDORIMIT TË QESEVE PLASTIKE NJËPËRDORIMËSHE

Sipas Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP), qeset plastike njëpërdorimëshe përdoren me një normë alarmante globale prej 5 trilionë copë në vit. Ato paraqesin një kërcënim masiv për mjedisin dhe shëndetin tonë në nivele të ndryshme. Prodhimi, transportimi dhe asgjësimi i tyre, përdor sasi të mëdha të burimeve jo të ripërtëritshme dhe liron sasi po aq të mëdha të gazrave që shkaktojnë ngrohjen globale. Ekologjikisht, qindra mijëra gjallesa detare dhe kafshë të egra vdesin çdo vit nga gëlltitja e qeseve të plastikës që gabimisht mirren si ushqim.

Ne Organizatat-Joqeveritare (OJQ) nënshkruese, kërkojmë nga Qeveria e Kosovës që të ndalon plotësisht përdorimin e një materiali të tillë toksik (qeseve plastike njëpërdorimëshe) në Kosovë, ose të paktën të aplikoj taksë shtesë për konsumin e këtyre qeseve nga prodhimi deri te shitja.

Në vitin 2019, Bashkimi Evropian miratoi një Direktivë për Plastikën Njëpërdorimëshe (SUP), duke i shënjestruar dhjetë produkte plastike të cilat gjenden më shpesh në plazhet dhe detet e Evropës. Ky akt është duke u transpozuar në ligjet kombëtare nga shtetet anëtare të BE-së. Përmes këtij akti synohet të ulet përdorimi i mbeturinave plastike në BE në më shumë se 50% për 10 artikujt më të zakonshëm, siç janë qeset plastike, gotat dhe shishet plastike. Ndalimet mbi plastikën njëpërdorimëshe raportohen të jenë të suksesshme nga ato qeveri dhe agjenci që i zbatojnë ato. Për shembull, në 2001 qeveria irlandeze vendosi një taksë mbi qeset plastike në pikat e shitjes, të njohur si "PlasTax" dhe u zbulua se brenda një viti nga vendosja e taksës, përdorimi i qeseve plastike në Irlandë pësoj rënie në më shumë se 90% dhe konsumi për person pësoj rënie nga 328 qese plastike në vit, në vetëm 21 qese në vit.

Disa vende të Ballkanit Perëndimor janë zotuar të i bashkohen iniciativës së BE për ndalim të produkteve plastike njëpërdorimëshe. Brenda rajonit, Shqipëria u kërkon shitësve vendosjen e tarifave për qese plastike në dyqanet ushqimore dhe tregje, si dhe që nga viti 2018 e ka ndaluar prodhimin dhe importin e të gjitha qeseve plastike të holla, jo të biodegradueshme.

Kosova përballlet me një sfidë të madhe në menaxhimin e mbeturinave. Vetëm bizneset vlerësohet të prodhojnë qese plastike me vlerë prej 5 milion euro në vit. Sipas Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë, vetëm 13% e mbeturinave plastike riciklohen. Pjesa më e madhe e mbeturinave në Kosovë vendosen në deponi, ose në mënyrë të paligjshme hidhen në ambiente të papërshtatshme apo digjen. Të gjitha këto forma të trajtimit të mbeturinave dëmtojnë tokën, ujin ose ajrin.

Ligjet dhe politikat aktuale në Kosovë (Ligji për Mbeturina Nr. 04 / L-060; Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013–2022 dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 11/2013 për përcaktimin e kërkesave teknike dhe kërkesave të tjera për qeset e plastikës) nuk janë mjaft specifike dhe veçanërisht ka mungesë të stimulimit për mospërdorim të qeseve plastike për kompani apo biznese. Paralelisht me këtë, Qeveria e Kosovës së bashku me akterët tjerë, duhet të angazhohen në mënyrë proaktive me synim rritjen e ndërgjegjësimit qytetar për rrezikun që vjen si rezultat i përdorimit të qeseve plastike dhe materialeve tjera të dëmshme për ekosistemin tonë.

Jemi të sigurt që nëse ndalojmë përdorimin e qeseve plastike, ose të paktën, kufizojmë disponueshmërinë duke e taksuar konsumin e tyre, të gjithë do të përfitojmë nga ndikimet pozitive.

Organizatrat nënshkruese (sipas alfabetit)

1. Advocacy for Society Development - AFSD
2. Balkan Green Foundation
3. BIO Natyra - Zymrije Salihu
4. Center for Political Courage
5. Debate center – Qendra e Debatit
6. Global Shapers Community, Prishtina
7. HANDIKOS
8. Iniciativa e Pavarur e të Verbërve të Kosovës
9. Iniciativa Qytetare Skenderaj
10. Initiative for Agricultural Development of Kosovo - IADK
11. Institute for Development and Policy - INDEP
12. Instituti Cilësor për Hulumtime Analiza dhe Trajnime - iCHAT
13. Instituti për Zhvillimin e Politikave Sociale – IZHPS
14. Kosovo Advocacy and Development Center - KADC
15. Kosovo Advocacy Group
16. Lëvizja FOL
17. Mundësia, Mitrovicë
18. NGO Lighthouse
19. OJQ Gjeomjedisi
20. OJQ Gruaja Hynore, Gjilan
21. OJQ Hareja
22. OJQ Nderi, Deçan
23. OJQ Ndërto të Ardhmen, Prishtinë
24. OJQ Vision 02
25. Partners Kosova Center for Conflict Management
26. Qendra e Gruas "ATO", Vushtrri
27. Qendra Kosovare për Studime Gjinore
28. Roma in Action, Gjakovë
29. Shoqata e Grave Aureola
30. Udruženje za Kulturu PLEJADA Prizren
31. The Balkan Forum